

## RELACION

### MBI PROJEKTAKTIN NORMATIV ADMINISTRATIV:

### PËR PROCEDURAT E ZGJIDHJES ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJES MIDIS KONSUMATORIT DHE OPERATORIT UJËSJELLËS KANALIZIME NGA STRUKTURA ZGJIDHJES ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJES

---

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT ADMINISTRATIV DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN

Qëllimi i këtij projekt akti: Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes midis konsumatorit dhe operatorit ujësjellës kanalizime nga struktura zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes” (*Projekt akti*) është vendosja e një kuadri rregullator për trajtimin dhe zgjidhjen alternative të një mosmarrëveshje në lidhje me detyrimet kontraktuale midis një operatori UK dhe një konsumatori përmes ndërmjetësimit me anë të një strukture përgjegjëse të ngritur pranë Entit Rregullator të Ujit.

Ligji Nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, në nenin 52/2, pika c, përcakton për veprimtaritë në fushën e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, funksionet e ZAM-it me konsumatorin kryhen nga Enti Rregullator i Ujit nëpërmjet Strukturës për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (SZAM).

Objektivi kryesor i projekt aktit është përcaktimi i procedurës dhe mekanizmave për funksionimin e strukturës përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) sipas përcaktimeve të ligjit Nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar dhe VKM Nr. 1089, datë 24.12.2020.

Gjithashtu një objektiv që synohet të arrihet nëpërmjet këtij projekt akti është dhe ai i zbatimit të një procedure për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në përputhshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve ligjit Nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar dhe të mos konkurrimit me procedurën që zbatohet për trajtimin e ankesave të parashikuara në nenin 30 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME POLITIKAT E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, OBJEKTIVAT RREGULLATORE DHE REKOMANDIMET E KUVENDIT

Projekt akti i propozuar për miratim në Komision, është në përputhje të plotë me politikat e Mbrojtjes së Konsumatorit të Këshillit të Ministrave, objektivat rregullatorë të ERRU për trajtimin dhe zgjidhjen alternative të një mosmarrëveshje midis një operatori UK dhe një konsumatori.

### **III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË**

Nxjerrja dhe miratimi e projekt aktit bazohet në kompetencën e Komisionit të përcaktuar në nenin 29, pika 1/i) për të nxjerrë rregulla për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuara në këtë ligj.

Ligji Nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, në nenin 52/2, pika c, përcakton se funksionet e ZAM-it me konsumatorin për veprimtaritë në fushën e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, do të kryhen nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU), në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar;

### **IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Në drejtim të përputhshmërisë me Acquis të BE-së, projekt akti gjen përputhshmëri me Direktivën 2013/11/EU mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve për mosmarrëveshjet konsumatore.

### **V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKAKTIT**

Projekt akti nga pikëpamja formale e përmbajtjes është strukturuar duke treguar vëmendje në zbatimin e rregullave të përgjithshme të teknikës legjislativë si dhe në ndërtimin e një akti administrativ normativ (Rregullore) sa më të kuptueshme dhe të qartë duke patur parasysh karakterin e tij si një bashkësi rregullash administrative procedurale të bazuar në ligjin nr. 44/2015. Projekt akti është ndarë në 4 (katër) kapituj të emërtuar:

Kreu I “Të përgjithshme”

Kreu II “Parime të përgjithshme”

Kreu III “Procedura e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve nga struktura e ZAM”

Kreu IV “Dispozita të fundme”

Në kreun e I-rë janë përfshirë qëllimi i rregullores, objekti, baza ligjore ku janë mbështetur dispozitat në përmbajtje të rregullores, përkufizime dhe fusha e zbatimit.

Në kreun e II-të janë përfshirë parimet mbi të cilat mbështetet zbatimi i rregullave procedurale nga ana e strukturës përgjegjëse të ZAM. Parimet e vendosura janë në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar. Gjithashtu në kreun II është përfshirë edhe përcaktimi i kompetencës së strukturës, pengesat ligjore, efektet e përjashtimit, për zbatimin e procedurës së zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes.

Në kreun e III-të janë përfshirë rregullat për krijimin e strukturës për ZAM, zbatimin e procedurës duke përcaktuar rregullat mbi veprimet administrative për paraqitjen e ankimit, regjistrimin e mosmarrëveshjes nga ERRU, fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, përfundimi i procedurës administrative me një zgjidhje të propozuar dhe një zgjidhje të detyruar.

Në kreun e IV-të janë përcaktuar dispozitat e fundme, hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

## **VI. RAPORTI I VLERËSIMIT FINANCIAR**

Projektakti nuk sjell asnjë pasojë financiare shtesë në buxhetin e ERRU pasi veprimet administrative që do të kryhen në përputhje me procedurën administrative për shqyrtimin e ankesave do të kryhen në kuadër të veprimtarisë së administratës së ERRU sipas strukturës dhe organikës dhe Komisionit, pa asnjë kosto shtesë.

## **VII. STRUKTURAT QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Procedura për regjistrimin e ankimit, përpunimin dhe administrimin shkresor të dokumentacionit dhe provave të paraqitura si dhe shqyrtimi i ankimit dhe vendimmarrja do të kryhet nga Struktura për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve.

## **VIII. STRUKTURA QË PËRGATITI PROJEKTAKTIN NORMATIV**

Projekt akti normativ u hartua nga Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit.